

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Gani Avdiu e Zenel Leku – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.P. nga fshati ..., komuna e Kamenicës, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.L.C. nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson i autorizuari SH.R., jurist i diplomuar nga fshati ..., komuna e Kamenicës, për shkak të tri pagave bazë për shpërblimin jubilar si dhe tri pagave mesatare për përcjellje në pension, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë C.nr.89/2017, të datës 04.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë C.nr.89/2017, i datës 04.12.2017, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.89/2017, të datës 04.12.2017, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit R. P. nga fshati ... dhe e ka detyruar të paditurën komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të tri pagave bazë për shpërblim jubilar si dhe tri pagave mesatare për përcjellje në pension, t’ia paguaj paditësit shumën prej 3.198.72 €, me kamatë 8 % nga dita e paraqitjes së padisë (18.05.2017) e deri në pagesën përfundimtare si dhe për shpenzimet e procedurës t’ia paguaj shumën prej 259 € dhe që kësaj gjykate në emër të taksës për vendim t’i paguaj shumën prej 12.50 €, krejt këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor e paditura ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, shikimit e leximit të shkresave dhe provave të zhvilluara, ta aprovoj ankesën, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën t’ia kthejë në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi R.ë P. me datë 18.05.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të pagesës së tri pagave bazë për shpërblimin jubilar si dhe tri pagave mesatare për përcjellje në pension, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.89/2017, të datës 04.12.2017, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata ka theksuar se nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi ka punuar tek e paditura si mësues klasor në SHFMU “Nuhi Berisha” në fshatin ... komuna e Kamenicës, me përvojë punë mbi 40 vite. Gjithashtu gjykata ka theksuar se nuk ishte kontestuese as fakti se tek e njëjta shkollë, paditësi ka dalë në pension. Gjykata më tutje ka theksuar se kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte fakti se a i takojnë paditësit tri paga jubilarë apo jo, ngase e paditura e ka kontestuar Kontratën Kolektive e cila parasheh që pagat jubilarë duhet të kërkohen sa punëtori është në punë dhe atë për çdo 10 vite. Gjykata ka theksuar se në bazë të Kontratës Kolektive përkatësisht me dispozitën e nenit 36 paragrafi 9, parashihet se mësimdhënësit gjegjësisht anëtarët e SBASHK-ut, përveç pagave përcjellëse për pension i takon edhe paga si shpërblim jubilar. Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata iu ka referuar Ligjit të punës nr. 03/L-212, ndërsa sa i përket kamatës gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së. Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në bazë të nenit 452 paragrafi 1 i LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimin të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimin, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension me datë 04.04.2017, dhe se i njëjti ka përvojë pune si mësimdhënës mbi 40 vite. Kjo rrethanë është provuar edhe nga vendimi i të paditurës nr.84 të datës 30.03.2017 dhe vërtetimi i SHFMU “Nuhi Berisha” në fshatin... komuna e Kamenicës, me nr. port. 9, të datës 13.03.2017, për pensionimin e punëtorit, këtu paditësit. Përveç kësaj nuk ka qenë kontestuese as lartësia e pagave.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.*

Me nenin 52 paragraf 1, të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të datës 18.03.2014, përcaktohet se “*I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: a) për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; b) për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij dhe c) për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. Me paragrafin 2 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: “punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë”, ndërsa në paragrafin 3 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se “Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.*

Me nenin 53 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se “*I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit”.* Tutje, me nenin 36 paragraf 9, të Kontratës Kolektive (sektoriale) të datës 11.04.2014, përcaktohet se: “*Punëtorët që dalin në pension përfshinë pensionin jubilar në vlerë: a) për 10 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, b) për 20 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të dy paga bazë, c) për 30 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë, d) punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar dhe e) shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve”.* Andaj mbi bazën e tërë të lartecukurave kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkespadinë e paditësit si të bazuar në tërësi, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1258/18, me datë 05.11.2018

Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari,
Valon Totaj